



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

Tiranë më, 27.03.2020

**NJOFTIM**

Me Urdhërin Nr. 154, datë 27.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe mbështetur në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, dhe në Vendimin Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pezullohen afatet administrative ndaj aplikantëve si më poshtë:

1. Pezullimi i të gjithë afateve administrative deri në një urdhër të dytë, që kanë aplikantët/përfituesit e programit Ipari II, Thirrja 1 dhe 2, si dhe njoftimi i aplikanteve/përfituesve për këtë ndryshim nëpërmjet faqes zyrtare të Webit të AZHBR-së.

Për të gjitha shkresat e reja që do ju dërgohen aplikantëve/përfituesve në vijim të afatit administrativ vini re si më poshtë:

“Mosrespektimi i këtij afati nuk do të jetë kusht skualifikimi gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore. Numërimi do të fillojë ditën e nesërme të njoftimit zyrtar, për përfundimin e periudhës së fatkeqësisë natyrore”

2. Për kontratat të cilat kanë afatin e realizimit gjatë kësaj periudhe, por për arsye objektive nuk arrijnë të realizojnë investimin, mjafton të dërgoni kërkesën për shtyrje me postë, dhe afatet administrative do të pezullohen dhe amendimi i kontratës do të bëhet, me një njoftim të dytë.
3. Aplikantët inkurajohen të plotësojnë sa më parë dokumentacionin shtesë, nëse kanë marrë një njoftim për të, në mënyrë që të vijojë procedura. Gjithsesi ju njoftojmë se mos plotësimi i tyre nuk është kusht skualifikues gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

4. Kërkesat apo dokumentat përkatëse dorëzohen me postë në adresën:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,

Rruga Muhamet Gjollesha, nr.56,

Tiranë

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**